



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësi Org Org.Jedinka Org.Unit	SP-02	Nr. Prot. Dok. Prot. Prot.No.	9225-2/25
Nr. fletëve Broj stranica No. pages	03	Data Datum Date	21.09.26
PRISHTINE/A			

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	17.09.2026
REFERENC-Ë:	25/9225//MMPH
PËR/ZA/TO:	"Benita Company" SH.P.K. Klinë Prodhimi i betonit në Preoc-Graçanicë
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 25/9225/MMPH, datë 30.12.2025, të parashtruar nga operatori "Benita Company" SH.P.K. Klinë, për prodhimin e betonit në Preoc-Graçanicë.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore për operatorin "Benita Company" SH.P.K. Klinë, për prodhimin e betonit në Preoc-Graçanicë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/9225/MMPH
Datë: 17.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Benita Company" SH.P.K. Klinë, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën me nr. prot. 25/9225/MMPH, datë 30.12.2025, për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. ref. 7441/19/MEA, dt. 04.12.2020, për prodhimin e betonit në ngastrën kadastrale nr. 584-3 në Preoc, Graçanicë.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore me nr. prot. 25/9225/MMPH, datë: 30.12.2025, të operatorit "Benita Company" SH.P.K. Klinë, për prodhimin e betonit në Preoc-Graçanicë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën në bazë administrative dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 10.07.2026 i ka kërkuar operatorit plotësim të dokumentacionit shtesë si në vijim:

- Leja Ujore e lëshuar nga ARPL për shfrytëzimin e ujit për nevojat e betonierës (leja e prezantuar e aplikim ju ka skaduar afati i vlefshmërisë);
- Leja Ujore e lëshuar nga ARPL për shkarkimin e ujërave nga betoniera (leja e prezantuar e aplikim ju ka skaduar afati i vlefshmërisë).

Operatori nuk ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Komisioni për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur me datë 25.08.2026, konstatoi se operatori "Benita Company" SH.P.K. Klinë, për prodhimin e betonit në Preoc-Graçanicë, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur më lartë në afatin kohorë të përcaktuar nën 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.